



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:100032

Datë: 01.02.2024

Numri i dokumentit: 05271018

PPP.nr.21/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG, Departamenti i Pergjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit TEB SH.A me seli në Graqanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blerim Halimi, avokat në Prishtinë, Rruga “Luan Haradinaj”, numër 12, ndaj debitorëve M.D, R.D, M.D1, S.D që të gjithë nga fshati V., Komuna Istog, me bazë juridike përmbarimore zbrasje dhe dorëzim i paluajtshmërisë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 01.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore, e udhëhequr sipas shenjës PPP.nr.21/2022 e iniciuar nga kreditori TEB SH.A me seli në Graqanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blerim Halimi, avokat në Prishtinë ndaj debitorëve M.D, R.D, M.D1, S.D që të gjithë nga fshati V., Komuna Istog, për shkak të tërheqjes së propozimit.

A r s y e t i m

Kreditori TEB SH.A me seli në Graqanicë, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit me bazë juridike përmbarimore zbrasje dhe dorëzim i paluajtshmërisë.

I autorizuari i kreditorit me parashtresën e datës 14.12.2023 ka tërhequr propozimin për përmbarim. Gjykata duke u bazuar në nenin 42 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën

Përmbartimore, ku përcaktohet se: *1. Propozimi për përmbartim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbartimore pa pëlqimin e debitorit. 2. Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbartim organi përmbartues e përfundon përmbartimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.*

Meqenëse në nenin 42 të LPP-së nuk parashihet se a lejohet apo jo ankesë kundër përfundimit të procedurës sipas këtij neni, gjykata duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore i cili përcakton se: *Në procedurën përmbartimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër e lidhur me nenin 261.4 i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton se: 261.4 Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi, gjen se në këtë rast nuk është e lejuar ankesa.*

Nga të lartë cekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
PPP.nr.21/2022, me datë 01.02.2024

Gj y q t a r j a
Pajtesë Boshnjaku

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.